

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11 dhe neni 55 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi 1 alineja 7 dhe nenin 39 paragrafi 1 alineja 3 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014, dhe në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-6597/7 nga data 30.12.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në mbledhjen e 25-të, të mbajtur më 30.12.2014, miratoi

## **DORACAK PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE PËR PLASMANIN E PRODHIMEVE**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Lënda**

1. Me këtë Doracak në mënyrë të detajuar përcaktohet mënyra e zbatimit të dispozitave për plasmanin e prodhimeve.

#### **Qëllimet**

2. Qëllimi i këtij Doracaku është që të jepen udhëzime të detajuara për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale për zbatimin e dispozitave për plasmanin e prodhimeve, e në veçanti:
  - të qartësojë nocionet, gjuhën dhe kategoritë që përdoren në Ligj;
  - ta qartësojë mënyrën e identifikimit të plasmanit të prodhimeve në programe;
  - ta bëjë transparente mënyrën se si Agjencia do të vlerësojë respektimin e dispozitave të plasmanit të prodhimeve në lloje të ndryshme të programeve;
  - të nxiste ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale që të zbatojnë dispozitat për pasimin e prodhimeve në mënyrë sa më të mirë të mundshme, duke mbrojtur interesat e publikut.

#### **Nocionet**

Në kuptim të këtij Doracaku, nocionet kanë këtë domethënie:

3. *Komunikimet komerciale audiovizuale* janë përmbajtje me zë ose fotografi me ose pa zë që janë të bëra:
  - për promovim direkt ose indirekt të prodhimeve, shërbimeve ose imazhit të personave fizik ose juridik që kryejnë aktivitet ekonomik, ose
  - për popullarizimin e ndonjë ideje ose aktiviteti ose për arritjen e ndonjë efekti tjetër.

Ato e shoqërojnë ose janë të përfshira në programin për kompensim në para ose kompensim tjetër ose për qëllime vetëpromovuese të porositesit. Format e

komunikimeve audiovizuele komerciale mes tjerash janë: reklamimi, teleshoppingu, sponsorimi dhe plasmani i prodhimeve.

4. *Plasmani i prodhimit* është secila formë e komunikimit audiovizuel komercial e cila përbëhet nga përfshirja ose potencimi i një prodhimi, shërbimi ose shenje mbrojtëse në ndonjë program, ashtu që ato janë të kyçura në veprimin e saj, për kompensim në para ose lloj tjetër të kompensimit. Si plasman i prodhimeve, që i nënshtrohen rregullave të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Doracak, do të llogaritet edhe secili përmendje gojore ose prezantim vizual i një marke (brendi) ose emri të një prodhimi shërbimi ose kompanie konkrete.
5. *Plasmani (përfshirja) e rekuizitave* është përdorimi i prodhimeve dhe shërbimeve (si rekuizita ose shpërbime të prodhuesit) në ndonjë program, në mënyrë që ato janë të futura në veprimin e tyre, pa u paguar kompensim në para ose kompensim tjetër. Përdorimi falas i rekuizitave të prodhimitarisë ka për qëllim të ndihmojë ose lehtësojë prodhimitarinë e programit.
- 6.
7. *Komunikimet e fshehta komerciale audiovizuele* paraqesin prezantimin me fjalë, zëra ose fotografi të mallrave, shërbimeve, emrit, shenjës mbrojtëse ose aktiviteteve të prodhuesit të mallrave ose ofruesit të shërbimeve në programe, kur për prezantimin e atillë, nga ana e ofruesit të shërbimit mediatik audiovizuel dedikohet për të shërbyer si reklamë dhe mund ta sjellë publikun në habi në lidhje me natyrën e tij. Prezantimi i këtillë konsiderohet se është kryer me qëllim, sidomos nëse është bërë për kompensim të hollash ose kompensime tjera.
8. *Sponsorimi* është cdo kontribut nga personat juridik ose fizik që nuk është i përfshirë në sigurimin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele ose në prodhimitarinë e veprave audio ose audiovizuele, me qëllim të financimit të shërbimeve mediatike audiovizuele ose të programeve, me qëllim që të promovojë emrin e tij, shenjën mbrojtëse, imazhin, aktivitetet ose prodhimet.

### **Përgjegjësia redaktuese dhe integriteti i programeve**

9. Plasmani i prodhimeve nuk guxon që të ndikojë mbi pavarësinë redaktuese dhe mbi integritetin e programeve të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele. Kërkesat e publikuesve, prodhimet e të cilëve plasohen në programe, nuk guxojnë të ndikojnë në skenarin, përmbajtjen, strukturën, prodhimitarinë ose kohën e emetimit të programit konkret.
10. Për autenticitetin dhe saktësinë e deklarimeve dhe të dhënave të shënuara deklaruar gjatë plasmanit të prodhimeve, përgjegjës është porositësi i tyre, kurse për harmonizimin e tyre me ligj, redaktori përgjegjës i ofruesit të shërbimit mediatik audiovizuel.
11. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele janë përgjegjës për ruajtjen e integritetit të programeve që janë pjesë përbërëse e shërbimit të tyre.
12. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele, gjatë lidhjes së marrëveshjes për prodhim të programit me producent të pavarur, do të duhej që të parashohin edhe dispozita me të cilat do të mbrojnë pavarësinë e tyre redaktuese ruajnë integritetin e programit.

## **II. RREGULLAT PËR PLASMANIN E PRODHIMEVE**

### **Rregullat e përgjithshme**

13. Plasmani i prodhimeve duhet patjetër të jetë menjëherë i njohur si i atillë.
14. Nuk lejohet plasmani i fshehur i prodhimeve.
15. Plasmani i prodhimeve nuk guxon të përdorë teknika të fshehta.
16. Plasmani i prodhimeve nuk guxon:
  - ta vejë në pikëpyetje respektimin e dinjitetit njerëzor;
  - të përfshijë ose promovojë çfarëdo diskriminimi në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë etnike, nacionalitetit, besimit ose bindjes, invaliditetit, moshës ose orientimit seksual.
  - të nxisë sjellje të dëmshme për shëndetin ose sigurinë;
  - të nxisë sjellje që dukshëm e rrezikojnë ambientin jetësor.
17. Ndalohet plasmani i prodhimeve me të cilat rrejshëm prezantohet natyra, karakteristikat, kualiteti ose prejardhja gjeografike e prodhimeve, shërbimeve, ose veprimtarive komerciale.
18. Plasmani i prodhimeve duhet të jetë:
  - në pajtim me rregullat e vlefshme ligjore që kanë të bëjnë me konkurrencën lojale;
  - drejtë dhe me nderë, të mos e mashtrojë publikun dhe të mos jetë kundër interesave të konsumatorëve.

### **Prodhime dhe shërbime, plasmani i të cilave nuk lejohet**

19. Në programe nuk lejohet plasmani i këtyre prodhimeve:
  - cigare dhe prodhime të duhanit, si dhe persona fizik dhe juridik që si veprimtari kryesorë e kanë prodhimin ose shitjen e cigareve dhe prodhimeve tjera të duhanit;
  - prodhime mjekësore dhe trajtime mjekësore që jepen vetëm me recetë mjekësore;
  - drogë, alkool dhe pije alkoolike, përveç verës dhe birrës;
  - armë, mjete gjuajtëse dhe piroteknike si dhe kompani që i shesin ato.

## **Rregullat për plasmanin e verës dhe berrës**

20. Plasmani i verës dhe berrës nuk guxon:

- konkretisht të jenë i dedikuar për të miturit, e veçanërisht nuk guxojnë që të emetohen të miturit se si e konsumojnë verën dhe berrën;
- ta lidhin konsumimin e tyre me aftësitë e përmirësuara fizike ose me drejtimin e automjetit;
- të krijojnë përshtypje se konsumimi i tyre kontribuon për sukses shoqëror ose seksual;
- të deklarojnë se vera ose birra kanë cilësi terapeutike ose se janë stimulues, qetësues ose mjete për zgjidhjen e konflikteve personale;
- të nxisin konsumimin e tyre pa masë ose ta paraqesin abstenimin ose maturinë në konotacion negativ dhe
- të potencojnë se përqindja e lartë e alkoolit është kualitet pozitiv i verës dhe berrës.

## **Prodhime mjekësore dhe trajtimet pa recetë mjekësore**

21. Plasmani i prodhimeve mjekësore dhe trajtimeve mjekësore që bëhen pa recetë mjekësore nuk guxojnë të nxisin përdorimin e tyre të pamatur, respektivisht duhet të prezantohen në mënyrë objektive dhe pa zmadhimin e cilësive të tyre, në pajtim me udhëzimet për përdorimin e tyre.

## **Ndalesë për nxitjen e drejtpërdrejtë ose theksimit të tepruar**

22. Programet që përmbajnë plasman të prodhimeve nuk guxojnë, që përmes promovimit të potencuar ose rekomandimit, drejtpërdrejtë ti nxisin konsumatorët që të blejnë ose huazojnë prodhimet ose shërbimet. Prodhimeve ose shërbimeve që plasohen në programe nuk guxon t'u kushtohet rëndësi e tepruar, përmes potencimit ose referimit tek to.

23. Edhe pse ndonjë prodhim, markë, emër ose shenjë mbrojtëse janë të emetuara në program, prapëseprapë ekspozimi ose përmendja e tyre nuk guxon që të bëhet në mënyrë jo të natyrshme të tepruar ose në mënyrë sulmuese me çka dukshëm promovohet prodhimi, shërbimi ose marka.

24. Udhëheqësit e programeve në të cilat plasohen prodhime ose shërbime duhet të shmangin që të flasin me lëvdata për kualitetin, çmimin ose se ku gjenden prodhimet ose shërbimet, si dhe të japin çfarëdo vlerësime pozitive ose rekomandime me të cilat nxiten konsumatorët që të blejnë ose huazojnë prodhimet ose shërbimet e plasuar.

25. Vlerësimi për atë se nëse programi ka nxitje të drejtpërdrejtë ose të theksimit të tepruar të ndonjë prodhimi ose shërbimit, konstatohet në veçanti për secilin rast, në bazë të cilit do kriter si vijon:

- karakteristikat e plasmanit, p.sh: hapësirës që është ndarë në ekran ose në studio;
- kohëzgjatjes dhe shpeshtësisë së përmendjes së emetimit;
- qëllimi dhe arsyeshmëria e përmendjes ose prezantimit nga aspekti i konceptit redaktues të programit konkret;
- gjuha që përdoret gjatë përmendjes, respektivisht mjeteve vizuale gjatë pasqyrimit.

### Shënimi i plasmanit të prodhimeve

26. Me qëllim të shmangies së habitës te shikuesit, programet që përmbajnë plasman të prodhimeve duhet të shënohen qartë, në fillim dhe në fund të programit, si dhe gjatë cdo vazhdimi të programit (nëse programi ndërpritet me pauza për reklamim).
27. TV programet që përmbajnë plasman të prodhimeve shënohen me theksimin e logos dhe tekstit në ekranin televiziv, në këtë mënyrë:
- logoja duhet të theksohet në cilëndo pjesë të ekranit dhe të mund të vërehet lehtë për shikuesit;
  - cdo paraqitje e logos patjetër duhet të përcillet me tekst;
  - cdo paraqitje e logos dhe tekstit në ekran duhet të zgjasë së paku 10 sekonda.

Pamja e logos dhe përmbajtja e tekstit që duhet të theksohen në ekranin televiziv:

VERSIONI PËR SFOND TË ERRËT	
	Program në të cilën janë plasuar prodhime!
VERSIONI PËR SFOND TË NDRITSHËM	
	Program në të cilën janë plasuar prodhime!

28. Nëse ofruesit e shërbimeve mediatiche audiovizuale dëshirojnë që ta theksojnë tërë listën e prodhimeve, shërbimeve ose markave që plasohen në program, mund ta bëjnë atë vetëm në fund të programit në spicën përmbyllëse (dhe/ose në pjesën e veçantë të ueb faqes së tyre që ka të bëjë me programin e emetuar konkret). Kur informata e atillë emetohet në program, atëherë ajo patjetër duhet të bëhet në mënyrë neutrale dhe jo promovuese, pa futjen shtesë të informatave tjera për prodhimet , shërbimet ose markat e plasura.
29. Nëse ofruesi i shërbimit mediatic audiovizuel emeton program të huaj me logo të futur prej më herët për plasman të prodhimeve, mund ta vendos atë logo në ekran. Mirëpo, krahas asaj logoje, patjetër duhet ta emetojë edhe tekstin e theksuar në tabelën lartpërmendur.
30. Nëse ofruesi i shërbimit mediatic audiovizuel emeton program të huaj në të cilën janë të plasura prodhime, por ajo nuk është e shënuar, me qëllim të mbrojtjes së

shfrytëzuesve të saj është e obliguar që ti shënojë prodhimet e plasuara, pa marrë parasysh që nuk ka interes financiar për të.

### **Programe në të cilat është e ndaluar plasmani i prodhimeve dhe plasmani i rekuizitave**

31. Plasmani i prodhimeve është i ndaluar në këto lloje të programeve, të përcaktuara me Doracakun për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 171/14):

- Këto lloje të programeve me funksion informativ: lajme ose TV ditarë, program aktual – informativ, program aktual -informativ me qasje dokumentare, program shou aktual dokumentar bisedues, transmetime ose incizime të seancave të organeve të pushtetit, transmetime ose incizime të ngjarjeve shoqërore – politike, magazina informative, program informativ -argëtues, shërbimi informativ, program informativ nga sfera e artit, kulturës dhe shkencave humaniste, programe për fëmijë me funksion informativ dhe programe tjera informative.
- Këto lloje të programeve me funksion arsimor: program arsimor; program dokumentar; program arsimor nga sfera e artit, kulturës dhe shkencave humaniste; program dokumentar me tematikë fetare; programe për fëmijë me funksion arsimor si dhe program tjetër arsimor.
- Këto lloje të programeve me funksion argëtues: program argëtues - informativ dhe programe për fëmijë me funksione arsimore.

32. Plasmani i rekuizitave është i ndaluar në të gjitha llojet e programeve në të cilat është i ndaluar plasmani i prodhimeve.

### **Plasmani i prodhimeve dhe sponsorimi**

33. Plasmani i prodhimeve dallohet nga sponsorimi me atë që përmendja e emrit të sponsorit ose emetimi i shenjës së tij mbrojtëse gjithmonë është e futur në skenarin ose skenografinë e prodhimit. Për dallim nga kjo, te sponsorimi, identifikimi i sponsorit patjetër duhet qartë të ndahet nga përmbajtja e programit.

34. Programet që përmbajnë plasman të prodhimeve dhe të cilat njëkohësisht janë të sponsoruara, i nënshtrohen rregullave për plasmanin e prodhimeve dhe rregullave të sponsorimit.

### **Plasmani i prodhimeve dhe reklamimi i fshehur**

35. Plasmani i prodhimeve është një praktikë që është e lejuar në lloje të veçanta të programeve, për dallim nga reklamimi i fshehur që është tërësisht i ndaluar.

36. Programet në të cilat plasohen prodhime, pa i shënuar qartë në mënyrë adekuate, do të konsiderohen si forma të reklamimit të fshehtë, respektivisht si shkelje e nenit 53 paragrafi 2 i Ligjit.

### **Shpërblimet si rekuizita**

37. Shpërblimet që ju ndahen pjesëmarrësve në programe ose shikuesve konsiderohen si plasim i rekuizitave. Si të tilla, ato duhet të identifikohen me gojë ose në mënyrë vizuale sipas të njëjtave rregulla që vlejnë për plasmanin e prodhimeve.

### **III. DISPOZITAT PËRMBYLLËSE**

38. Ky doracak hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuale**

**Kryetar i Këshillit**

**Llazo Petrushevski, d.v.**

Nr. 01-6700/1  
30.12.2014  
Shkup